



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Prill 2021

Nr: 258

V E N D I M
P Ë R

**“SHTYRJEN E AUDITIMIT PËR FONDET E PËRFITUARA DHE SHPENZUARA
GJATË VITIT KALENDARIK 2020 NGA PARTITË POLITIKË”.**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “dh”, “ë”, “n” dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe të neneve 23, 23/1, 23/2, 23/4 dhe 24 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar,

VEREJ:

Në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve janë depozituar kërkesa nga financierët e Partisë Socialiste të Shqipërisë me nr. prot. 122, datë 08.04.2021, protokolluar me tonën nr. prot. 3458, datë 9.04.2021, Partisë Demokratike të Shqipërisë me nr. prot. 59, datë 13.04.2021, protokolluar me tonën nr. prot. 3716, datë 13.04.2021 dhe Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim me nr. prot. 193, datë 13.04.2021, protokolluar me tonën nr. prot. 3766, datë 14.04.2021, për shtyrjen e afatit të auditimit për fondet e përfituara dhe shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020 nga partitë politike.

Për shkak se periudha e auditimit vjetor këtë vit korespondon në muajin e fushatës zgjedhore të zgjedhjeve të 25 prillit 2021 dhe financierët e partive janë të ngarkuar me raportet financiare për fushatën zgjedhore të Kuvendit të datës 25 Prill 2021.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “dh”, “ë”, “n” dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23, 23/1, 23/2, 23/4 dhe 24 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar, si dhe bazuar në pretendimin e ngritur nga



financierët e Partisë Socialiste të Shqipërisë, Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për shtyrjen e auditimit financiar vjetor, për vitin 2020 për partitë politike,

V E N D O S:

1. Të shtyj afatin për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik 2020.
2. Auditimi i fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, gjatë vitit kalendarik 2020, do të kryhet gjatë muajit Shtator 2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

